

RAPORTI VJETOR 2024

Përgatitur për:

Mbledhjen e XVII-të të
Kuvendit të STIKK

12 Shkurt, 2025

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
2. INFOGRAFIKË	5
2. AKTIVITETET E STIKK PËRGJATË VITIT 2024	
3.1 Objektivi 1	7
3.2 Objektivi 2	10
3.3 Objektivi 3	13
3.4 Objektivi 4	17
4. RAPORTI FINANCIAR	22
6. KUVENDI I XVI-të I STIKK	23
7. ANËTARËT E ARTË	24

Gjatë vitit 2024, Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës (STIKK) ka realizuar një sërë iniciativash të rëndësishme për të avancuar zhvillimin e industrisë së TIK në Kosovë, duke ndjekur një qasje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse. Misioni i STIKK për këtë vit ka qenë të ndihmojë kompanitë anëtare në rritjen e tyre, duke kontribuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe financiare, zgjerimin e mundësive për shitje në tregjet lokale dhe ndërkombëtare dhe promovimin e identitetit të industrisë në arenën globale. Përmes katër objektivave strategjikë të përcaktuar qartë, STIKK ka demonstruar një përkushtim të vazhdueshëm për të mbështetur zhvillimin e sektorit TIK si një nga shtyllat kryesore të ekonomisë kosovare.

Një nga prioritetet e STIKK gjatë vitit 2024 ka qenë përmirësimi i aftësive dhe njohurive profesionale të burimeve njerëzore në sektorin TIK. Shoqata ka organizuar një numër të konsiderueshëm trajnimesh dhe punëtorish, të cilat kanë trajtuar tema nga më të ndryshmet, përfshirë cloud computing, metodologjitë Agile, menaxhimin e objektivave dhe zhvillimin e aftësive të buta për gratë sipërmarrëse. **Trajnimet kanë përfshirë mbi 100 pjesëmarrës**, duke krijuar një bazë të fortë për përgatitjen e një fuqie punëtore të kualifikuar. Një tjetër arritje ka qenë **krijimi i një platforme dixhitale** për grumbullimin dhe analizimin e të dhënave mbi sektorin TIK, e cila synon të ndihmojë kompanitë dhe vendimmarrësit në marrjen e vendimeve strategjike. Megjithatë, disa sfida kanë penguar përfundimin e aktiviteteve të rëndësishme si publikimi i IT Barometrit 2023 dhe zhvillimi i plotë i nismës “Bridge” për lidhjen e kompanive me institucionet arsimore. Pavarësisht këtyre pengesave, STIKK ka vendosur bazat për përparime të mëtejshme në këto fusha.

STIKK ka luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e kuadrit ligjor për sektorin TIK në Kosovë. Shoqata ka marrë pjesë në një sërë grupesh punuese për hartimin dhe amandamentimin e ligjeve dhe strategjive, duke përfshirë Ligjin e Punës, Ligjin për Inovacion dhe Ndërmarrësi dhe Strategjinë Nacionale të TIK. STIKK ka qenë gjithashtu aktive në adresimin e çështjeve që lidhen me incentivat fiskale për aktivitetet edukativo-arsimore dhe zgjerimin e e-qeverisjes.

Një ndër arritjet më të mëdha ka qenë angazhimi në diskutimet për Fondin e Inovacionit, ku STIKK ka mbrojtur qëndrimin se ky fond duhet të menaxhohet nga një organ i pavarur dhe i përbërë nga ekspertë të fushës. Përmes kësaj qasjeje proaktive, Shoqata ka siguruar që zëri i industrisë të dëgjohet në tryezat e vendimmarrjes dhe që nevojat e sektorit të adresohen në mënyrë adekuate.

Në vitin 2024, STIKK ka vazhduar të mbështesë kompanitë anëtare në përpjekjet e tyre për të hyrë në tregje të reja dhe për të zgjeruar kapacitetet e tyre tregtare. Aktivitetet B2B kanë qenë një nga pikat kryesore, me pjesëmarrje të suksesshme në Austri dhe Berlin. Në Austri, 12 kompani kosovare morën pjesë në ViennaUP, duke tejkaluar synimet e parashikuara dhe duke krijuar mundësi të reja bashkëpunimi. Ndërkohë, në Berlin, kompanitë anëtare prezantuan zgjidhje inovative në kuadër të Global Gastronomy Festival, duke shënuar një tjetër hap përpara për industrinë. Përveç aktiviteteve ndërkombëtare, STIKK ka organizuar dy evente të rëndësishme rrjetizimi – Techbeque dhe KosICT Reception – të cilat kanë shërbyer si platforma për ndërlidhje dhe bashkëpunim mes bizneseve. Megjithëse disa iniciativa, si B2B në Linz dhe Stuttgart, nuk u realizuan, përpjekjet për organizimin e një B2B në Zvicër janë duke u konkretizuar për vitin 2025.

Organizimi i festivalit **KosICT** shënoi një nga arritjet më të mëdha të vitit. Ky edicion mbledhi mbi 3,000 pjesëmarrës nga 15 shtete, përfshirë 104 kompani dhe 30 folës, prej të cilëve 23 ndërkombëtarë. Me 17 sesione kryesore dhe 8 të tjera në Developers Stage, KosICT ofroi një platformë për diskutime mbi teknologjinë, inovacionin dhe trendet globale. Ngjarja përfshiu gjithashtu takime B2B, panairë të kompanive dhe startup-eve dhe aktivitete për zhvillimin e aftësive të rinjve, duke reflektuar një sukses të jashtëzakonshëm në ngritjen e profilit të industrisë.

Në të njëjtën kohë, **Tech Park Prishtina** ka funksionuar si një qendër aktivitete, duke organizuar mbi 35 evente dhe trajnime, ndërsa kampanjat për promovimin e TIK dhe përfshirjen e grave në sektor kanë pasur një ndikim të rëndësishëm. Nisma si **Java e Vajzave në TIK** dhe peticioni për ccTLD kanë treguar përkushtimin e STIKK për të promovuar barazinë gjinore dhe për të adresuar sfidat teknologjike që prekin vendin.

Puna e STIKK gjatë vitit 2024 ka qenë e pasur me aktivitete dhe arritje që kanë ndihmuar në përmirësimin e kushteve të sektorit TIK dhe në rritjen e kapaciteteve të tij. Nga trajnime të specializuara dhe projekte ligjore deri te organizimi i eventeve ndërkombëtare dhe përmirësimi i imazhit të industrisë, STIKK ka treguar një angazhim të qëndrueshëm për mbështetjen e kompanive anëtare dhe zhvillimin e sektorit. Përmes këtij raporti, pasqyrohet një vit i suksesshëm që shërben si bazë për avancime të mëtejshme në të ardhmen.

B2B TAKIME: 4

KONFERENCA/PANAIRE: 3

GRUPE PUNUESE: 10

TAKIME TE REALIZUARA: 100+

ANËTARË TË RINJ: 16

MIKKENA GLOBAL

QUANTIX

MATES STUDIO

ARALYTIKS

TEMNEX

KCDE

TERMINI BEAUTY

BLINKAPP

THE LOBBY BOY

GENZ

IPKO FOUNDATION

CAP COIN


INDEX KOSOVA

ALGORITHMICS


HV PRINT

BRITISH GYMNASIUM OF TECHNOLOGY


TOTAL




ARTË




ARGJEND




BRONZ



THJESHTË



BASHKËPUNUES



INDIVIDUAL

Ndjekës



12,889

↑ 2%



5,184

↑ 14%



725

↑ 59%

8,694

↑ 3%




2,040

↑ 19%



1,429

↑ 34%

TE HYRAT



SHPENZIMET



Përgjatë vitit 2024, ekipi i **STIKK** ishte mjaft aktiv me aktivitete, takime e iniciativa të ndryshe përmes të cilave u munduam t'i përmbahemi dhe përmbushim objektivat e përcaktuara. Në vazhdim mund t'i gjeni detajet e ndara në objektivat përkatës.

OBJEKTIVI 1: NGRITJA E KAPACITETEVE NJERËZORE PËR NEVOJAT E KOMPANIVE ANËTARE DHE ZHVILLIMIT TË TREGUT TË TIK

Gjatë vitit 2024, STIKK ka qenë e angazhuar në zbatimin e një sërë aktiviteteve me qëllim rritjen e kapaciteteve njerëzore të kompanive anëtare dhe zhvillimit të tregut TIK në Kosovë. Dëshira për të fuqizuar burimet njerëzore është pasqyruar në disa fusha kryesore, përfshirë realizimin e IT Barometrit 2023, organizimin e trajnimeve, nismën “Bridge” dhe funksionimin e Këshillit Sektorial të TIK-ut. Më poshtë paraqiten të arriturat, sfidat dhe vlerësimi për secilën prej nën-aktiviteve.

1.1. Implementimi i IT Barometrit 2023

Një nga iniciativat kyçe ka qenë hartimi dhe publikimi i IT Barometrit, përmes të cilit synohej mbledhja e të dhënave mbi tendencat dhe kërkesat e sektorit. Fillimisht, STIKK hartoi një pyetësor, duke marrë parasysh edhe komentet e anëtarëve, dhe e kodoi atë në bashkëpunim me UBO Consulting.

Megjithatë, numri i përgjigjeve të mbledhura nga bizneset ishte i ulët. Kjo e bëri të pamundur nxjerrjen e rezultateve domethënëse për vitin 2024. Për rrjedhojë, publikimi i këtij studimi nuk u realizua sipas planit. Sidoqoftë, puna paraprake e kryer gjatë vitit, përfshirë dizajnin e pyetësorit dhe konsultimet me anëtarët, ka krijuar një bazë të rëndësishme, e cila do të mundësojë një analizë më përfaqësuese nëse gjendet një qasje e përshtatshme për grumbullimin e më shumë përgjigjeve.

1.2. Organizimi i trajnimeve sipas nevojave të anëtarëve të STIKK

Një përparësi tjetër e rëndësishme e STIKK ka qenë ofrimi i trajnimeve cilësore në fusha relevante për sektorin e TIK-ut.

Në këtë drejtim, gjatë vitit janë organizuar 8 trajnime dhe punëtori, ku mund të veçohen:

- Sesione mbi temat AWS – Cloud Practitioner, Agile & Scrum Master, Objective and Key Results (OKR),
- Punëtori me ekspertë ndërkombëtarë në kuadër të Founders Retreat,
- Trajnime për zhvillimin e soft skills, me theks te roli i grave sipërmarrëse në TIK.

Në disa prej këtyre trajnimeve u arrit një pjesëmarrje e kënaqshme nga kompanitë anëtare, por jo në të gjitha u përmbush plotësisht synimi për të patur të paktën 10 kompani për trajnim. Ndërkaq, edhe pse u planifikuan të paktën 9 trajnime, u realizuan 8. Ky rezultat është vlerësuar si i mirë në rrethanat aktuale, duke marrë parasysh edhe ndryshimin e dinamikave të tregut.

1.3. Iniciativa “Bridge” për bashkëpunimin me institucionet arsimore

Iniciativa “Bridge” ka për qëllim të krijojë ura bashkëpunimi mes kompanive të sektorit TIK dhe institucioneve të arsimit të lartë apo profesional, përmes ligjëratave, punëtorive dhe vizitave. Në fillim të vitit, tre kompani anëtare shfaqën interes për të mbajtur sesione “Bridge” në FIEK dhe Fakultetin e Arteve.

Për arsye të ndryshme organizative dhe moskoordinimit të duhur të orareve, këto sesione nuk u zhvilluan gjatë vitit 2024. Me gjithë këtë sfidë, STIKK ka vazhduar komunikimin me universitete dhe kolegje private, duke hulumtuar mundësi të mëtejshme për realizimin e kësaj nisme. Puna e deritanishme ka ndihmuar në identifikimin e vështirësive logjistike dhe në krijimin e kontakteve të nevojshme për të bashkërenduar në të ardhmen një numër më të madh aktiviteteve “Bridge”.



1.4. Zhvillimi i fuqisë punëtore përmes Këshillit Sektorial të TIK-ut

Këshilli Sektorial i TIK-ut ka luajtur një rol të rëndësishëm në grumbullimin e të dhënave, propozimin e politikave mbështetëse dhe krijimin e mundësive për partneritet mes akterëve publikë e privatë. Gjatë vitit 2024:

- STIKK mbledhi të dhëna nga kompanitë anëtare lidhur me Ligjin Nr. 06/L-105 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, duke identifikuar interesimin dhe njohuritë mbi dispozitat për zbritjen e shpenzimeve edukativo-arsimore,
- U zhvillua dhe u testua një platformë dixhitale që ofron të dhëna të agreguara mbi sektorin TIK, përfshirë numrin e kompanive, vëllimin e eksportit dhe importit, qarkullimin vjetor, numrin e të punësuarve etj.,
- U iniciuan diskutime mbi incentivën fiskale për aktivitetet edukativo-arsimore dhe u trajtuan çështje të validimit të aftësive profesionale në sektor.
- U përzgjedh një organizatë e specializuar (Digital Skills Foundation) për të kryer një studim fizibiliteti mbi shkathtësitë në sektorin e TIK-ut dhe mundësitë për vendosjen e një kornize validuese.

Këto veprime kanë krijuar një bazë solide në drejtim të politikave afatgjata për zhvillimin e fuqisë punëtore, duke promovuar një qasje të strukturuar në mbledhjen e të dhënave dhe dialogun e vazhdueshëm me institucionet relevante.

Gjatë 2024-ës, STIKK ka investuar burime të konsiderueshme për të përmirësuar dhe zgjeruar kualifikimet e fuqisë punëtore në sektorin TIK, duke mbështetur kompanitë anëtare me një gamë të gjerë trajnimesh, punëtorish dhe iniciativash bashkëpunuese. Edhe pse disa rezultate si publikimi i **IT Barometrit 2023** dhe **zhvillimi i plotë i sesioneve 'Bridge'** nuk u arritën brenda afateve të parapara, puna dhe angazhimi i deritanishëm kanë vendosur bazën për sukses gjatë vitit 2025.

Nga ana tjetër, realizimi me sukses i **platformës dixhitale për të dhënat e sektorit, organizimi i trajnimeve cilësore, kontributi i STIKK në diskutimet rreth incentivit fiskal**, si dhe **mbështetja për gratë në TIK** dëshmojnë përkushtimin tonë për zhvillimin e sektorit. Bazuar në progresin e vitit 2024, vlerësojmë se **Objektivi 1 është realizuar rreth 60%**. Kjo shifër pasqyron një progres domethënës, duke marrë parasysh se një pjesë e aktiviteteve tashmë janë në proces dhe kërkojnë një kohë më të gjatë për t'u finalizuar apo për të dhënë rezultate të matshme.

OBJEKTIVI 2: PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS LIGJORE DHE QASJES NË FINANCA

Gjatë vitit 2024, STIKK ka dëshmuar përkushtim të plotë në drejtim të pjesëmarrjes aktive në proceset vendimmarrëse, duke synuar përmirësimin e kuadrit ligjor dhe rritjen e mundësive të financimit për sektorin e TIK-ut. Pavarësisht sfidave të ndryshme, STIKK ka marrë pjesë në mënyrë sistematike në grupet punuese, ka ofruar komente për nismat ligjore dhe strategjike, si dhe ka qenë e zëshme në tryezat e diskutimeve ku janë trajtuar çështje kyçe për industrinë.

2.1 Pjesëmarrja në grupet punuese për ligje dhe strategji

Qasja proaktive e STIKK-ut gjatë këtij viti është reflektuar në angazhimet në forume, takime dhe mbledhje të ndryshme, ku janë diskutuar amandamentimet ligjore dhe hartimi i strategjive që prekin komunitetin TIK. Në takimet e organizuara nga Këshilli Kombëtar për Ekonomi dhe Investime (KKEI), STIKK ka theksuar domosdoshmërinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm me sektorin privat në procesin e hartimit të politikave. Po ashtu, gjatë prezantimeve në këto tryeza, STIKK ka nxitur zgjerimin e e-qeverisjes, duke theksuar rëndësinë e digjitalizimit të shërbimeve qeveritare si një faktor kyç për rritjen e efikasitetit dhe transparencës institucionale.

Në vijim, STIKK ka vazhduar të përfaqësojë interesat e kompanive anëtare përmes pjesëmarrjes në diskutimet mbi ligje dhe strategji kyçe, si Ligji i Punës, Ligji për Inovacion dhe Ndërmarrësi, Strategjia Nacionale e TIK, Strategjia për Specializim të Mençur dhe Ligji për Sponsorizimet.



Përgjatë këtyre takimeve, përfaqësuesit e STIKK-ut kanë argumentuar në favor të mundësive më të mëdha për investime, fiskalizim më të favorshëm për veprimtaritë edukativo-arsimore dhe lehtësira ligjore që do të ndihmonin sektorin të mbetet konkurrues në rajon.

Një pikë tjetër e rëndësishme e vitit ka qenë përpjekja e STIKK-ut për të qenë pjesë e secilit diskutim formal apo joformal, edhe kur fillimisht mund të jetë anashkaluar. Kjo qasje ka ndihmuar shoqatën të mbrojë interesat e anëtarëve në kohë reale, sidomos në rastet kur përpilohej dokumentacioni për fondet qeveritare apo politikat publike me impakt të drejtpërdrejtë në TIK.

2.2 Puna rreth Fondit të Inovacionit

Një ndër rastet ku STIKK fillimisht u përball me vështirësi për t'u përfshirë, por më pas arriti të jetë ndër kontribuuesit kyç, ishte diskutimi mbi Fondin e Inovacionit. Në takimet e mbajtura nën udhëheqjen e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), STIKK paraqiti qëndrimin se menaxhimi i Fondit duhet të bëhet nga një organ i pavarur, i përbërë nga ekspertë të fushës, në mënyrë që të garantohet përdorimi efektiv dhe i drejtë i mjeteve financiare. Duke ofruar sugjerime konkrete mbi kriteret e përzgjedhjes së projekteve dhe format e monitorimit, STIKK ka synuar të sigurojë që investimet në inovacion të kenë ndikim të matshëm dhe afatgjatë në sektorin TIK.

Përveç avokimit në grupet punuese, STIKK ka qenë aktive edhe në shpërndarjen e informatave të kompanitë anëtare, duke i njoftuar ato për kohën e thirrjeve, kriteret e aplikimit dhe përfitimet e mundshme. Në këtë mënyrë, përmes takimeve këshilluese, janë krijuar ura komunikimi mes anëtarëve dhe institucioneve publike, me qëllimin final të rritjes së pjesëmarrjes së kompanive kosovare në diskutimin publik dhe skemat mbështetëse.

Gjatë vitit 2024, STIKK ka arritur të përmbushë në mënyrë tërësore objektivin e përmirësimit të infrastrukturës ligjore dhe qasjes në financa, duke qenë prezent në të gjitha tryezat e rëndësishme ku janë diskutuar politikat që prekin sektorin, si dhe duke luftuar për t'u përfshirë kudo që ekziston mundësia për kontribut të shtuar.

Këto angazhime kanë mundësuar avancimin e çështjeve që janë me rëndësi për komunitetin TIK, përfshirë incentivat fiskale, strategjitë kombëtare dhe menaxhimin profesional të fondeve publike.

Në bazë të kontributit të ofruar dhe rezultateve të arritura, vlerësohet se **Objektivi 2 është realizuar në masën 100%** gjatë vitit 2024. Ky rezultat ilustron vendosmërinë e STIKK-ut për të mbrojtur interesat e kompanive anëtare, duke siguruar një ambient sa më të favorshëm ligjor dhe financiar për zhvillimin e industrisë TIK në Kosovë.

OBJEKTIVI 3: ZGJERIMI I MUNDËSIVE PËR SHITJE NË TREGUN LOKAL DHE NDËRKOMBËTAR

Gjatë vitit 2024, STIKK ka realizuar një sërë veprimtarish me qëllim rritjen e aksesit të kompanive anëtare në tregje të reja, si dhe forcimin e pranisë së tyre në tregun vendor. Në vijim paraqitet një pasqyrë kohezive e arritjeve, sfidave dhe rezultateve kyçe të lidhura me Objektivin 3.

3.1. Themelimi i një instrumenti të Ndhmës Juridike në vend të Bashkimit European

Një prej iniciativave më specifike gjatë këtij viti ka qenë përpjekja për të themeluar një instrument të ndhmës juridike për kompanitë anëtare të STIKK-ut në Bashkimin European. Qëllimi ishte ofrimi i shërbimeve këshilluese dhe mbrojtjes ligjore në lidhje me kontratat ndërkombëtare, regjistrimin e produkteve apo shërbimeve, si dhe çështje të tjera që lidhen me operimin në tregun e BE-së.

Në kuadër të kësaj nisme, STIKK i është drejtuar disa donatorëve për mbështetje financiare dhe logjistike. Ndonëse kërkesa fillestare nuk u aprovua, shoqata ka vijuar komunikimet me burime të tjera për financim dhe identifikimin e partnerëve të mundshëm. Deri në fund të vitit 2024, instrumenti i ndhmës juridike ende nuk është themeluar dhe, për rrjedhojë, nuk është funksionalizuar. Kjo nënkupton se KPI-ja e paraprë për këtë pikë nuk është realizuar brenda vitit aktual.

3.2. Organizimi i CEO events për rrjetizim mes bizneseve

Me qëllim nxitjen e bashkëpunimeve dhe shkëmbimit të praktikave midis kompanive, STIKK ka organizuar dy evente kryesore rrjetizimi:

- Techbeque – një barbeque me karakter joformal, ku morën pjesë rreth 20 kompani, përfshirë startup-et e Tech Park Prishtina dhe kompani anëtare të STIKK. Eventu mundësoi takime të frytshme midis pjesëmarrësve dhe krijoi mundësi për diskutime mbi bashkëpunime të reja.
- KosICT Reception – një pritje zyrtare, ku ishin të pranishëm rreth 70 pjesëmarrës, përfshirë udhëheqës kompanish, sipërmarrës, investitorë dhe figura kyçe të ekosistemit TIK. KosICT Reception u konceptua si platformë për t'i prezantuar zhvillimet më të fundit të industrisë dhe për të shkëmbyer ide rreth zgjerimit në tregje të reja.



Këto dy aktivitete plotësojnë KPI-në e planifikuar sa i përket organizimit të eventeve CEO/Networking, duke ofruar një ambient të përshtatshëm për rrjetizim dhe bashkëpunim ndërmjet kompanive vendore.

3.3. Organizimi i aktiviteteve B2B ndërkombëtare

Një shtyllë thelbësore e Objektivit 3 ka qenë mbështetja e kompanive anëtare për të prezantuar produktet dhe shërbimet e tyre në tregje ndërkombëtare. STIKK ka kërkuar dhe në disa raste siguruar partneritet me donatorë, organizata dhe rrjetin Enterprise Europe Network (EEN) për të organizuar apo lehtësuar B2B evente në vende të ndryshme:

- **B2B në Austri (Vienna):** STIKK ndërmjetësoi pjesëmarrjen e 12 kompanive kosovare, duke tejkaluar objektivin e parashikuar prej 6 kompanish. Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të festivalit ViennaUP, një ngjarje e rëndësishme e sipërmarrjes në Austri, ku kompanitë patën mundësi të prezantojnë zgjidhjet e tyre dhe të rrjetizohen me investitorë e partnerë të mundshëm.
- **B2B në Linz:** Për këtë destinacion, STIKK u përpoq të siguronte mbështetje dhe interes nga kompanitë anëtare, por nuk u arritën kushtet e nevojshme financiare e logjistike. Si pasojë, ky aktivitet nuk u organizua gjatë vitit 2024.
- **B2B në Stuttgart:** Rasti i ngjashëm me Linz; përpjekjet fillestare në shtetin e Baden-Württemberg nuk rezultuan në numrin e mjaftueshëm të partnerëve gjermanë për të realizuar një B2B të suksesshëm. Ngjarja u shty për t'u shqyrtuar sërish në vitin vijues.

- **B2B në Zvicër:** STIKK ka siguruar mbështetje për një event B2B në Nyon, planifikuar për muajin mars 2025, ku pritet të marrin pjesë të paktën 10 kompani zvicerane të interesuara për bashkëpunim me kompanitë kosovare. Për këtë qëllim, është finalizuar bashkëpunimi me kompaninë VR4Business, e cila do të lehtësojë organizimin e aktivitetit.
- **B2B në Berlin:** Në datat 2–4 tetor, STIKK ka bashkëpunuar si bashkëorganizator në Global Gastronomy Festival (GAG), duke nxitur kompanitë anëtare që të ekspozojnë shërbimet ose produktet e tyre. Kjo ngjarje, megjithëse e orientuar në gastronomi, ofroi mundësi edhe për sektorin e TIK-ut, sidomos në fushën e zgjidhjeve dixhitale për hotele dhe restorante.

Vlen të theksohet se, përkundër shtyrjeve dhe mosrealizimeve në Linz dhe Stuttgart, përpjekjet në Austri dhe Berlin treguan rezultat pozitiv, ndërsa aktiviteti në Zvicër pritet të jetë një mundësi e re bashkëpunimi përgjatë vitit të ardhshëm.



3.4. Pjesëmarrja në konferenca

STIKK ka vepruar si ndërmjetës aktiv edhe në fushën e konferencave ndërkombëtare, me theks te DMEXCO në Gjermani dhe Viva Technology në Francë:

- **DMEXCO – Gjermani:** Për pjesëmarrjen e kompanive kosovare në DMEXCO, KIESA ka mundësuar mbështetje financiare, ndërsa STIKK është angazhuar në përhapjen e njoftimeve dhe informacionit tek anëtarët, duke i inkurajuar ata për të shfrytëzuar këtë mundësi prezantimi. Ky bashkëpunim ka krijuar një qasje më të strukturuar në evenimentet me përmasa globale.

- **Viva Technology – Francë:** STIKK ka sugjeruar këtë konferencë si një ndër prioritetet e kalendarit vjetor të eventeve ku kompanitë nga Kosova mund të marrin pjesë. Megjithëse pjesëmarrja planifikohej gjatë vitit 2024, ajo është vendosur të mbështetet nga agjencia e re për promovim dhe investime në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, e cila po përgatit plane për vitin 2025.

Ky angazhim në konferenca si DMEXCO dhe Viva Technology synon të rrisë dukshmërinë e industrisë TIK të Kosovës në nivele rajonale dhe ndërkombëtare, duke i ofruar kompanive një hapësirë për rrjetizim, ekspozim të ideve dhe vendosje kontakti me klientë apo partnerë potencialë.

Përpjekjet e STIKK-ut gjatë vitit 2024 kanë mundësuar rritjen e mundësive për shitje dhe prezantim të kompanive anëtare si brenda vendit, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Organizimi i CEO events, pjesëmarrja në disa B2B të suksesshme në Evropë dhe përfshirja në konferenca kryesore kanë ndihmuar në promovimin e ekosistemit TIK të Kosovës. Sidoqoftë, disa iniciativa – si themelimi i instrumentit të ndihmës juridike apo zhvillimi i plotë i disa B2B-ve të planifikuara në shtete të caktuara – nuk u realizuan ose mbetën në fazën e parë të negociatave.

Duke u mbështetur në KPI-të e caktuara, vlerësohet se **Objektivi 3 është përmbushur afërsisht në masën 70%** gjatë vitit 2024. Në raport me aktivitete si B2B në Austri, është tejkaluar synimi i pjesëmarrjes, ndërsa në disa raste të tjera ka munguar realizimi për shkak të rrethanave organizative apo mungesës së partnerëve të mjaftueshëm. Pavarësisht këtyre sfidave, rezultatet e arritura tregojnë një angazhim solid të STIKK-ut për të mbështetur kompanitë anëtare në zgjerimin e tyre në tregun lokal dhe në atë ndërkombëtar.

OBJEKTIVI 4: PËRMIRËSIMI I IDENTITETIT TË INDUSTRIË DHE POTENCIALIT VENDOR NË TREGUN NDËRKOMBËTAR

Gjatë vitit 2024, Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe Komunikimit të Kosovës (STIKK) ka zbatuar me përkushtim një sërë iniciativash për të forcuar identitetin e industrisë TIK vendase dhe për të rritur dukshmërinë e saj në arenën ndërkombëtare. Objektivi 4 ka përfshirë një gamë të gjerë aktiviteteve, nga komunikimi i rregullt digjital e deri te organizimi i festivalit KosICT dhe funksionalizimi i TechPark Prishtina. Gjatë këtij viti, STIKK ka synuar të arrijë rezultate konkrete përmes bashkëpunimit me kompanitë anëtare, institucionet publike dhe partnerët ndërkombëtarë, duke promovuar zhvillimin teknologjik dhe inovacionin, por edhe duke nxitur vetëqëndrueshmërinë e Shoqatës.

4.1. Promovimi i veprimtarisë dhe aktiviteteve të STIKK, temave me rëndësi për sektorin, si dhe aktiviteteve me kompani anëtare

Në fushën e komunikimit publik dhe promovimit të aktivitetit të STIKK, një vëmendje e veçantë i është kushtuar mënyrës së shpërndarjes së informacionit tek komuniteti i anëtarëve dhe te publiku i gjerë. Rrjetet sociale të Shoqatës kanë përjetuar një rritje domethënëse të ndjekësve, që llogaritet në rreth 22% krahasuar me një vit më parë, duke tejkaluar objektivin e parashikuar prej 20%. Në të njëjtën kohë, janë shfaqur forma të reja komunikimi, si newsletter-i mujor, i cili është dërguar në dhjetë raste tek anëtarët e Shoqatës. Në këto përmbledhje dixhitale, STIKK ka njohur kompanitë e reja që i janë bashkuar Shoqatës, ka publikuar oferta të ndërsjella për shërbime dhe produkte, si dhe ka prezantuar projektet kryesore në zhvillim e sipër. Kjo metodë ka shërbyer për të ruajtur një kontakt të pandërprerë me komunitetin e biznesit TIK, duke u siguruar që anëtarët të kenë qasje të shpejtë dhe të lehtë në informacione me interes.

4.2. Vizitat tek kompanitë anëtare dhe joanëtare

STIKK i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe vizitave tek kompanitë, si anëtare, ashtu edhe ato joanëtare. Këto takime janë planifikuar kryesisht përmes platformës Calendly dhe kanë ofruar mundësinë për diskutim rreth sfidave, planeve dhe mundësive të bashkëpunimit.

Disa kompani kanë rezervuar takimet e tyre online, ndërsa të tjerat janë kontaktuar nga vetë ekipi i STIKK-ut, duke pasur parasysh angazhimet e shumta në sektor. Të gjitha këto vizita i kanë mundësuar Shoqatës që të kuptojë më mirë situatën reale në terren dhe të krijojë sinergji mes bizneseve, duke u ofruar atyre informacione, mbështetje ose mundësi për projekte të reja.

4.3. Organizimi i festivalit KosICT (11–12 tetor 2024)

Një nga ngjarjet më të rëndësishme vjetore për industrinë TIK në vend, KosICT, këtë vit arriti edicionin e tij të 13-të, duke u mbajtur në datat 11 dhe 12 tetor në hapësirën e Tech Park Prishtina. Këtë herë, festivali i teknologjisë tërhoqi mbi 3,000 pjesëmarrës nga 15 shtete të ndryshme, së bashku me 104 kompani dhe 30 folës, prej të cilëve 23 erdhën nga jashtë Kosovës. Në këtë edicion, i cili tejkaloi dukshëm parashikimet e mëparshme, u organizuan gjithsej 17 sesione në Main Stage dhe 8 të tjera në Developers Stage, ku u trajtuan temat më aktuale në zhvillimin teknologjik, sipërmarrjen inovative dhe trendet e së ardhmes në TIK. Veç këtyre diskutimeve, KosICT ofroi një gamë të gjerë aktiviteteve mbështetëse, si Trailblazers Fair, ku u prezantuan 10 kompani, dhe Innovation Fair, e cila tërhoqi vëmendjen përmes 11 startup-ëve pjesëmarrës. Po ashtu, Future Developers Corner mbledhi të rinj të pasionuar pas teknologjisë, disa edhe të moshës 8–16 vjeç, të cilët demonstuan qasje krijuese ndaj inovacionit. Element tjetër kyç i festivalit ishte Brokerage event, ku u organizuan 150 takime biznesi (B2B), duke krijuar ura të rëndësishme bashkëpunimi mes kompanive vendore dhe atyre ndërkombëtare. KosICT shërbeu njëherazi si mjedisi ideal për prezantimin e nismës OCTOBERTECH Kosova, një rrjet i ndërthurur eventesh teknologjike, me mbështetjen e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, i cili vijoi për gati një muaj të plotë me aktivitete nga DOKU.Tech dhe GrowthTank, duke i dhënë një shtysë domethënëse ekosistemit inovativ të vendit.



4.4. Funksionalizimi i TechPark Prishtina

Përveç sukseseve në organizimet tradicionale, Tech Park Prishtina ka pasur një rol vendimtar si qendër graviteti për një sërë aktivitete, trajnimesh dhe eventesh. Gjatë vitit 2024, kjo hapësirë ka pritur më shumë se njëzet aktivitete të profileve të ndryshme, nga trajnime specifike për startup-et, deri te sesione diskutimi për çështje si e-commerce ose inteligjenca artificiale. Institucionet qeveritare, organizatat ndërkombëtare dhe vetë komuniteti TIK e kanë parë Tech Park Prishtina-n si vendin e duhur për të realizuar takime, panele, ekspozita dhe prezantime produktesh, duke e forcuar pozicionimin e parkut si një qendër inovacioni. STIKK ka bashkëpunuar edhe me Komunën e Prishtinës dhe Zyrën e Kryeministrit për të zhvilluar një plan strategjik lidhur me këtë infrastrukturë, duke synuar që Tech Park Prishtina të luajë një rol edhe më të madh në të ardhmen, si një pikë kyçe në ekosistemin e startup-eve dhe teknologjisë në Kosovë. Gjatë vitit 2024, janë nënshkruar 3 MoU me parqet teknologjike Technology Park Varaždin (Kroaci), Sakarya Teknokent (Turqi) dhe ICUK (Republika Çeke) për të nxitur bashëpunimin në projekte ndërkombëtare.



4.5. Kampanja për promovim të TIK sipas temave

Gjithashtu, me qëllim promovimin e industrisë TIK ndaj grupeve të ndryshme të interesit, Shoqata ka organizuar dhe mbështetur një varg fushatash e nismash në lidhje me tema të rëndësishme për komunitetin.

Nisma si “Java e Vajzave në TIK” ka qenë një prej tyre, gjatë së cilës gra sipërmarrëse nga 9 komuna u janë drejtuar shkollave të mesme për të përcjellë përvojat e tyre dhe për të inkurajuar vajzat e reja që të ndjekin studimet teknologjike. Në kuadër të po të njëjtës nismë, u organizua një eveniment në TechPark ku morën pjesë 80 gra nga 9 sektorë të ndryshëm, duke iniciuar bashkëpunime të reja. Shoqata ka bashkëpunuar edhe me DigiWoman Cluster për të mundësuar takime B2B, ku sipërmarrëset në TIK kanë pasur mundësi të krijojnë partneritete ose të prezantojnë shërbimet e tyre para sektorëve të ndryshëm të industrisë. STIKK priti në vizitë zyrtare Ambasadorin e BE në Kosovë, Aivo Orav. Kjo ishte vizita e parë që ambasadori mbajti në një projekt të mbështetur nga BE në Kosovë. Gjatë vizitës, ambasadori vizitoi Tech Park, startup-et e mbështetura nga projekti STARUP si edhe mbajti një takim me ekzekutivin e STIKK. Një fushatë tjetër me efekt afatgjatë ka qenë ajo që lidhet me ccTLD-në për Kosovën, ku STIKK ka hartuar një peticion dhe ka krijuar një taskforcë të dedikuar për këtë çështje, duke synuar njohjen e Kosovës në platformat teknologjike ndërkombëtare. Megjithatë takimi me odën ekonomike gjermane u shty për arsye objektive, veprimet e Shoqatës në drejtim të avancimit të ccTLD-së tregojnë vendosmërinë për të arritur rezultate konkrete në vitet e ardhshme.

4.6. Kampanja për promovimin e CSR

Në drejtim të përgjegjësisë sociale, STIKK ka ndërmarrë vetëm një aktivitet kryesor që rezulton i raportuar, përkatësisht turneun e eSports për bamirësi gjatë KosICT, i cili ka shërbyer për të mbledhur mjete financiare dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi çështje sociale. Megjithatë fillimisht ishin planifikuar dy aktivitete CSR, brenda vitit 2024 është zhvilluar vetëm ky turne i lojërave elektronike, duke i lënë hapur mundësitë për nisma të mëtejshme në të ardhmen.



4.7. Vetëqëndrueshmëria e STIKK

Në pjesën e vetëqëndrueshmërisë, STIKK ka vazhduar ta forcojë strukturën dhe burimet e saj financiare, duke nënshkruar projekte me donatorë të ndryshëm, si Swisscontact (Swiss EP), EnInGeP, USAID Compete Activity, Komuna e Prishtinës dhe LuxDev. Po ashtu, me miratimin e pakove të reja të anëtarësisë në Kuvendin e 16-të, Shoqata ka krijuar kushte më të mira për rritjen e numrit të anëtarëve dhe për përfitimin e tyre nga shërbimet që ofrohen. DigiWomen Cluster ka qenë aktiv gjatë tërë vitit, duke organizuar takime, plane veprimi dhe duke operuar si një grup homogjen për gratë në TIK. Të gjitha këto zhvillime i japin mundësi Shoqatës të ketë një bazë më solide operimi dhe të ofrojë akoma më shumë shërbime për kompanitë anëtare.

Nga gjithë sa u përmend, mund të vërehet se shumica e objektivave dhe indikatorëve janë realizuar ose tejkaluar, si rritja e prezencës në kanalet digjitale, organizimi i festivalit KosICT, nënshkrimi i disa projekteve madhore dhe vënia në funksion e TechPark Prishtina. Në të njëjtën kohë, mbetet një hendek i vogël në realizimin e plotë të dy aktiviteteve të parashikuara në fushën e CSR, si dhe disa detaje logjistike të papërfunduara (si për shembull, linja e re e transportit drejt Tech Park Prishtina). Në përgjithësi, megjithatë, është arritur një progres i konsiderueshëm, duke iu afruar **objektivit të 4-të në masën rreth 90%**. Kjo përqindje reflekton përmbushjen e pjesës dërrmuese të qëllimeve të përcaktuara, si dhe dallon një impuls të fortë të Shoqatës për të konsoliduar e promovuar më tej industrinë TIK në Kosovë.

Pasqyra e te ardhurave		01.01.2024-31.12.2024
Te hyrat		
Te hyrat nga trajnimet		1,363
Te hyrat nga projektet		301,630
Te hyrat nga Qiratë ne Tech Park		9,391
Te hyrat nga eventet		10,214
Te hyrat nga anetaresite		31,340
Te hyrat nga B2B		3,800
Total te hyrat		357,737
Shpenzimet		
Pagat		109,753
Tech Park		78,984
Shpenzime te eventeve		5,716
Shpenzime te Transportit lokal		1,293
Shpenzime te Transportit nderkombetar		4,052
Pagesat e internave		17,092
Pagesat e trajnereve		37,521
Auditimi dhe sherbime ligjore		1,489
Shpenzime te zhvleresimit		26,135
Girls in ICT		2,690
KosICT		102,200
Per diem EYE Exchange		560
Per diem STAR UP		7,601
Administrative		9,556
Total shpenzimet		404,643
NET INCOME		-46,906

STIKK mbajti Asamblenë e 16-të të Përgjithshme më 20 mars 2024, me praninë e 39 përfaqësuesve të kompanive anëtare. Kuvendi miratoi pakot e reja të anëtarësisë dhe planin e punës për vitin 2024 i cili fokusohet në 4 objektiva:

1. Ngritja e kapaciteteve për nevojat e kompanive anëtare dhe zhvillimi i tregut të STIKK;
2. Përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe aksesit në financa për kompanitë e TIK-ut;
3. Zgjerimi i mundësive të shitjes në tregun vendor dhe ndërkombëtar;
4. Përmirësimi i identitetit të industrisë dhe potencialit vendor në tregun ndërkombëtar.

Në mbledhjen e Kuvendit gjithashtu u votua Bordi i ri Drejtues:

- President - Ermal Sadiku (LinkPlus)
- Zëvendës Presidente - Zana Tabaku (Appdec)

Anëtarët:

- Vigan Budima (Aseeco),
- Fatos Gacaferri (Nettxio),
- Faton Selishta (Kutia),
- Alban Sahiti (Tenton),
- Bardha Ajvazi (Brandfluence),
- Benjamin Kolenovic (Growzillaz),
- Kristian Kabashi (Kin+Carta).



Our Services

BUILT FOR YOUR PROJECTS, YOUR WORKFLOWS, YOUR GOALS, YOUR TEAM



Software Development

Software development services can streamline your day-to-day operations into a faster and more cost effective...



Software Testing & QA

Software Testing & Quality Assurance services have become an essential part of the success of every software proje...



Software Training

Appdec is provider of software development training in Albanian speaking population in Balkan's region...



Technology Consulting

The aim of our team in software consultancy is the optimisation of resources and processes in a project...



Project Management

Effective project management is our focus providing development of successful software solutions within...



Integration & Migration

When businesses/corporations grow, the processes also grow and there is an apparent need for system changes but...



Maintenance & Support

Appdec provides software maintenance and support services that ensure that software application systems are up a...



Creative Design

Appdec offers a range of free services, genuine established client or a seriously interested party and prospected client...

CONTACT US



+383(0)38557606



info@appdec.com



www.appdec.com



Street 28 Nëntori, No.10 Dardania
10000 Prishtina, Republic of Kosova

Bring Great Ideas to Life

Beriflapp is a leading Swiss software development company dedicated to turning visionary ideas into tangible solutions. With a strong foundation in innovation and expertise in cutting-edge technologies, we provide businesses with the tools they need to thrive in a digital world.



WHAT WE DO



Custom Software Development:

- Tailor-made solutions for your unique needs.
- Development using state-of-the-art technologies such as .NET, Go, Angular and React.



Artificial Intelligence (AI)

- AI integration to automate and enhance business processes.
- Development of AI-powered applications to optimize value creation.



Cybersecurity

- Protecting your data and systems through secure architectures.
- Solutions to safeguard your digital infrastructure.



SaaS Solutions

- Development and delivery of cloud-based applications.
- Examples: Capture.ch, a SaaS solution for tire dealers, and LEA, a platform for school transport.



Dedicated Teams

- Highly skilled teams focused on delivering results for your projects.

WHY CHOOSE BERIFLAPP?

- **Innovation:** We use the latest technologies to give you a competitive edge.
- **Customer Focus:** Your requirements are at the center of everything we do.
- **Reliability:** We guarantee high quality and on-time delivery.
- **Swiss Precision:** With a focus on quality, security, and scalability.

SUCCESS STORIES

- Trusted by prestigious institutions like the University Hospital Zurich and Zurich City.
- Successful pilot phases for our flagship products, now ready for broader market adoption.

Let's Collaborate: whether you're a startup with a groundbreaking idea or an established business looking to modernize, Beriflapp is your partner in innovation.

Together, we can bring great ideas to life.





Kutia is a software development company that helps startups and businesses grow through customized software solutions.

Founded in 2013, our company has been an example of sustainable growth. With a team of over 70 experts, we have successfully served more than 60 clients and completed more than 160 projects.

Operating from offices in Kosovo, Albania, and the USA, and proficient in English, German, and Swedish, we adhere to the highest industry standards with certifications in ISO:9001, ISO:27001, and EU GDPR compliance.

Our core services cover diverse solutions:

- > **Web Development** (Cloud Solutions)
- > **Mobile Application**
- > **E-commerce**
- > **UX/UI design**

Two main working models

- 1** Custom Software Solution: Full management of the software development lifecycle, delivering solutions from conception to launch.
- 2** Dedicated Teams: Deployment of experts exclusively assigned to work on existing projects. Operating from offices in Kosovo, Albania, and the USA, and proficient in English, German, and Swedish, we adhere to the highest industry standards with certifications in ISO:9001, ISO:27001, and EU GDPR compliance.

Main Industries

- > **Healthcare**
- > **Fintech**
- > **Real Estate**
- > **IGaming**
- > **Gas and Oil**
- > **IoT**
- > **Retail**

Our tech expertise includes front-end technologies like ReactJS, AngularJS, and VueJS, back-end proficiency in NodeJS and PHP, mobile development using React Native and Flutter.io, and CMS mastery with WordPress and CraftCMS. We've made a mark across various industries globally, contributing to projects in the USA, Sweden, Norway, Germany, Switzerland, Bulgaria, Albania and Kosovo.

Beyond business, our commitment to sustainable growth is just as important as our business. To build new capacities in Kosovo, in 2020, we brought the Beetroot Academy – a global Swedish IT Academy, in Kosovo. Until today, we have trained over 850+ students in the latest IT skills, with 85% currently employed, and awarded 445+ scholarships for women in IT, children in STEAM & students at public universities.

Nacew Company Profile

Nacew is a world-class digital product development company that works with state governments and tech startups in creating applications and devices that cater to more than 30+ million active users worldwide. The company is headquartered in Kosovo, employs 25+ employees and its customers are located across New York, Berlin and Riyadh.

With its primary mission of revolutionizing digital experiences for people worldwide, the exceptional Nacew team comprises individuals with extensive experience working with leading global companies the likes of Disney, Snapchat and TikTok showcasing its global experience and unparalleled expertise in developing digital products.

The company is focused on three core areas:

UI/UX Services

Flagship Project: Saudi Arabia's renowned Tawakalna superapp, showcases Nacew's world-class expertise and dedication to enhancing digital experiences. It is developed in collaboration with the Saudi Arabian government, respectively SDAIA. It offers its 30+ million residents a user-friendly platform with a range of more than 240 integrated public services and information. Up to this day and beyond, Nacew continues to be a partner of many other Saudi Governments' superapps.

Gen-AI Product Development

Flagship Project: Gen-AI SaaS platform, owned & developed by Nacew, helps UI/UX designers generate unique and ready-to-use design systems and mobile app interfaces by simply prompting a request on its app interface. Aided by Artificial Intelligence (AI), this digital platform enables UI/UX designers to swiftly create the design systems of their apps without the need to waste endless hours in doing manual work and facing design inconsistencies and flaws.

IoT Device Development

Flagship Project: IoT device, owned and developed by Nacew, is an anti-parking device, a portable unit designed to attach to a violator's windshield to deter unauthorized parking. It includes mechanical locks, sensors, electronics for identification and alerts, and a rugged external shell. The IoT device also uses a central device designed to host these units, identify them, recharge their batteries, and managing data communication with the back-office.

Nacew is a member of International Design Zentrum (IDZ) in Berlin. Founded in 1968, the International Design Center Berlin (IDZ) is a leading, independent German design institution which promotes design as a driver for business and social innovation.

WHO ARE WE?



NETTXIO provides Network Infrastructure Services to evolve and optimize networks of all types. NETTXIO stands out as a trusted outsourcing partner for telecommunications companies due to our industry expertise, innovative solutions, and commitment to delivering exceptional results. With a proven track record in managing complex projects and streamlining operations, we empower our clients to achieve their business objectives with confidence and efficiency.

OUR EXPERTISE

NETTXIO has extensive experience delivering various projects for major telecom providers. We continue to partner with top telecom clients, leveraging advanced technology to address the evolving needs of network expansion and infrastructure scalability. Key NETTXIO resources have provided support in different capacities for several major clients throughout Europe and the US. Our leadership team brings decades of diverse experience across key domains, including engineering, implementation, and managing large-scale projects for major carriers. This wealth of expertise ensures that we deliver strategic insights and practical solutions tailored to your unique business needs.

COMPREHENSIVE SOLUTIONS

Our team of seasoned experts provides comprehensive, end-to-end solutions encompassing:

- Site Scoping and Acquisition
- Site Construction & Installation
- Service Provisioning (Core & Backhaul)
- Network Migration
- Network Operations Center (NOC)
- Software Development
- Fintech

NETTXIO provides high-level service delivery, from initial phase analysis to post-deployment support, tailored to meet customer demands. With our proven expertise and industry track record, we offer seamless, high-quality service to meet the demands of modern telecom infrastructure

🌐 [Nettxio.com](https://nettxio.com)

✉️ contact@nettxio.com



Radix is an online - cloud based - multifamily market research and analytics platform with built-in tools designed to help users make sense of ambiguous data and drive performance.

We are on a mission to change how the multifamily industry makes decisions by equipping teams with real-time data and visualization tools which produce reliable and insightful market trends.



At Radix we have 5 Core Values:

COURAGE

CURIOSITY

RESILIENCY

RESPONSIBILITY

IMPACT

We believe that these values are essential for achieving professional and personal success and that by living these values we will have a more fulfilling life and we can have a positive impact in all areas of our lives including family, work, communities, and the world at large.



Sentry™

Exceptional
Cyber Security
Services.



ADDRESS:

TechPark Prishtina, Bërnice e
Poshtme, Prishtinë
10000, Kosovo



WEBSITE:

www.stikk.org



PHONE:

+383 48 21 05 55



EMAIL

infoi@stikk.org



STIKK
KOSOVO ICT ASSOCIATION